



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:185928

Datë: 30.06.2023

Numri i dokumentit: 04443022

PKR.nr.243/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova Kryetare e trupit gjykues, Sami Sharraxhiu dhe Shaqë Curri anëtarë të turpit gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bute Ramosaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit N.I. nga f. P., K. Gj., rr. “P. H. A.”, për vepër penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së, dhe për vepër penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda PP/I.nr.250/2022 të datës 14.12.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurores së shtetit Valbona Disha Haxhosaj të akuzuarit N.I. dhe mbrojtësi i tij av. Ndrec Dodaj nga Gjakova sipas autorizimit, me datë 19.06.2023 mori dhe shpalli, si dhe me datë 30.06.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N.I., i lindur me datë, në Gj., me banim në f. P., K. Gj., rr. “P. H. A.”, i biri i R. dhe i nënës F. e gjinisë K., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i . fëmijëve, punon te një firmë te Gj. si menagjer i pikës, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I.Më dt.08.09.2022, rreth orës 17:00 min në f. D. K. K., pa autorizim e me qëllim të shitjes, ka transportuar nga Gjakova për në Prishtinë substanca narkotike të llojit marihuanë, në atë mënyre që zyrtaret policor nga Njësi i DHTN-së në Gjakovë, me datën e cekur si më lart por në ora 16:45 min, kanë vërejtur të pandehurin N.I. duke lëvizur me veturën e tij te markës A. ..., ngjyrë e hirit me targa ..-...-.. në drejtim te rrugës Gjakovë –Klinë, me çrast të njëjtit menjëherë kanë njoftuar patrullën policore ne Klinë të cilët rreth orës 17:00 e kanë ndaluar të pandehurin në f. D., policia e ka legjitimuar, dhe ne momentin kur i pandehuri N. e kishte hapur bagazhin, zyrtaret policor kanë ndjerë aromën

e substancës narkotike e në këtë moment i pandehuri N. me shpejtësi është futur në automjet ashtu me bagazh të hapur së bashku me dëshmitaren S.A. dhe me vozitje të vrullshme ka ikur në drejtim të rrugës Klinë- Prishtinë, duke u futur në një rrugë me zhavorr që të dërgon te seperacioni “K. T.”, dhe meqenëse nuk kishte dalje policia të njëjtit ia bllokojnë rrugën, ku gjatë bastisjes së automjetit në një pjesë të bagazhit policia gjejnë dy qese najloni të mbushur me substanca narkotike të llojit marihuanë në peshë rreth 1kg e 425 gr, kurse gjatë bastisjes në lokalit e të pandehurit në G., policia gjejnë dhe sekuestrojnë substancën narkotike të llojit marihuanë në peshë të përgjithshme prej 536 gr marihuanë, të cilat substanca pas ekzaminimit kanë rezultuar të llojit marihuane në peshë të përgjithshme prej 1641.36 gr, si dhe 14.075 euro.

-Me çka ka kryer veprë penale, blerja, posedim, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 të KPRK-së.

II. Në periudhë kohore të pacaktuar e gjerë me datë 08.09.2022, në f. P. K. Gj., në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll armën dhe atë një revole e markës S. S. P..., me nr serik se bashku me dy karikator dhe 12 fishekë të kalibrit .x.. mm, në atë mënyrë që policia gjatë bastisjes dhe kontrollit të shtëpisë së të pandehurit të njëjtit i gjejnë dhe sekuestrojnë armën e cekur si më lartë.

-Me çka ka kryer veprë penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71,72,76, nenit 267 par. 2 të KPK, neni 366 par.1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

1.Për veprën e parë penale si në dispozitivin e parë të cekur si më lart i caktohet:

- dënim me gjobë në shumën prej 1000 € (njëmijë euro)

- dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj.

2.Për veprën e dytë penale të cekur si më lart i caktohet dënim gjobë në shumë prej 1000€ (njëmijë euro).

3.Konform nenit 76 të KPRK-së shqiptohet dënim unik me gjobë në shumën prej 2000€ (dymijë euro) që do të ekzekutohet më së largu në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj që do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në këtë dënim me burgim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.08.09.2022 gjer me dt. 05.11.2022 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.05.11.2022 e gjer me dt.29.12.2022.

Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afat të caktuar prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një dite burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës.

4.Të akuzuarit i konfiskohen përhershëm:

- Substanca narkotike i llojit marihuana në peshë prej 1641.36 gr.
- arma- pistoletë e markës S. S. P..., me numër serik se bashku me dy karikator dhe 12 fishekë të kalibrit .x.. mm, të cilat gjendet në zingjirin e ruajtjes sipas rastit policor-DHTN-..., dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen.

-Shuma e parave prej 14.075€ (katërbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë euro)

-Automjeti xhip i markës A. ..., ngjyrë hiri me targa ..-...-.. me numër të shasisë me pronarë i akuzuari N.I..

5. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro), në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.250/2022 të datës 14.12.2022, ndaj të akuzuarit N.I. nga f. P., K. Gj., rruga “P. H. A.”, për veprë penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPK-së, dhe për veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/I.nr.250/2022 të datës 14.12.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari N.I. ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe është konsultuar me mbrojtësin e pranon fajësinë për veprën penale nga dispozitivi i dytë i aktakuzës dhe atë për veprë penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, pranimin e fajësisë e bënë vullnetarisht pa kurrfarë presioni, premtim apo detyrim nga askush. Ndërsa i akuzuari në seancë fillestare nuk e ka pranuar fajësinë për veprë penale: blerja, posedim, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 të KPRK-së.

Me pranimin e fajësisë për veprën penale të cekur si më lartë janë pajtuar prokurorja dhe mbrojtësi i të akuzuarit i cili ishte prezent.

Në shqyrtim fillestar gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 241 të KPRK-së,

Procedura ka vazhduar për veprën penale: blerja, posedim, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 të KPRK-së. I akuzuari dhe as mbrojtësit e tij nuk kanë paraqitur kundërshtim me shkrim dhe gjykata më pas ka caktuar shqyrtimin gjyqësor.

Në shqyrtim gjyqësorë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores vetëm për veprën e parë si në dispozitivin e parë të aktakuzë, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata sërish ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari N.I. ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe është konsultuar me mbrojtësin e pranon fajësinë për veprën penale blerja, posedim, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 të KPRK-së, me vullnet te plot.

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale nga dispozitivi parë i aktakuzës, i cili pranim korrespondon edhe me provat në bazë të cilave është ngritur aktakuza e që gjendet në shkresat e lëndës, më pas duke pasur parasysh faktin se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare pa presion pa ndonjë premtim, pajtohet me këtë pranim, ashtu që i propozon Gjykatës që të njëjtin ta aprovoi.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Ndrec Dodaj ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit meqë ky pranim është në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore ashtu që i propozoj Gjykatës që të njëjtin ta aprovoi.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 241 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: meqenëse i akuzuarit N.I. gjatë shqyrtimit fillestar, fillimisht ka pranuar veprën penale nen piken II te dispozitivit të aktakuzës dhe atë për vepër penale " mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve" nga neni 366 par i te KPRK-se, kurse sot gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka pranuar fajësinë për vepër penale nen pikën një të dispozitivit të aktakuzës "blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substanca psikotrope dhe analoge" nga neni 267 para 2 te- KPRK-se, për të cilat vepra prokuroria ka vërtetuar dyshimin mirë të bazuar se i njëjti i ka kryer në vend kohë dhe mënyrë të përshkruar si ne dispozitivat e aktakuzës, atëherë nuk me mbetet gjë tjetër veç se te mbes pranë aktakuzës, përshkrimit faktin dhe juridik te veprave penale i propozoi gjykatës qe te njëjti ta shpalle fajtor ta dënoi sipas ligjit si dhe te obligoi ne kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale. Po ashtu i propozoi gjykatës që sendet dhe provat e propozuara në aktakuzë për konfiskim të njëjtit të konfiskohen kurse lidhur me rastin e marrjes se vendimit mbi dënim i propozoi gjykatës qe si rrethana renduese gjykata të vlerësoi faktin, pra dashjen e të pandehurit për të kryer veprën penale, rrezikshmërinë e lart te kësaj vepre, kurse si rrethane lehtësuese të vlerësoi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.I. av. Ndrec Dodaj në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, gjendja faktike nga aktakuza nuk është me kontestuese pasi qe pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat materiale nga shkresat e lendes, ashtu qe nga gjykata kërkoi qe me rastin e marrjes se vendimi mbi dënimin te vlerësoi rrethanat lehtësuese qe janë një numër i konsiderueshëm në rastin konkrete siç është pranimi i fajësisë, pastaj i njëjti nuk ka të kaluarën kriminale, pranimin e fajësisë gjykata ta konsideron ne mënyrë te vazhdueshme qe nga fillimi i hetimit, pasi qe në seancën fillestare kemi një deklarim ndryshe

nga i pandehuri, por nuk është faji i pandehurit, mund të jete mos koordinim në lidhje me deklarin e seancës fillestarë, ndërsa në rrethanat rënduese që u referua prokurori mendoi që nuk ka ndonjë peshe me u vlerësua, pasi që kjo vepër penale po thuajse është vepër penale e rëndomtë, kur rrethanat lehtësues mbi peshojnë mbi rrethanat rëndues, dhe kërkoi që të shqiptohet një dënim sa më i bute me të cilën do të arrihet qëllimi i ndëshkimit..

I akuzuarit N.I., në fjalën përfundimtare deklaroi se: pajtohet me fjalën e avokatit, dhe ndihet shumë fajtor për veprën që e kam bërë, për arsye se unë i kam tre fëmijë, kërkoi falje dhe nuk do të përsëritës këtë vepër penale dhe as ndonjë vepër tjetër.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë: pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i policit I. Xh. i datës, raporti i rreshterit M. M. i datës, raporti i oficerit H. S. i datës me nr. të rastit-DHTN-..., vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës, vërtetimi mbi sekuestrimin e automjetit i datës, përmbajtja e dosjes forenzike nr. N.-...-.. e datës në ora 17:00, raporti plotësues i hetuesit H. S. i datës, raporti i ekspertimit daktiloskopik me nr. .../...-.../...-... i datës, raporti i ekspertimit të telefonave i datës, raporti plotësues i datës së bashku me dy CD të raportit elektronik të ekzaminimit të telefonave me nr. A.-...-..., raporti i A.../...-.../...-... i dt..... mbi ekzaminimit e substancës narkotike, andaj gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtor.

Bazuar në dispozitivin e nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, është penduar dhe ka premtuar se nuk do të kryej vepër penale në të ardhmen, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata ka vlerësuar shkallën e lartë të dashjes që dëshmohet nga sasia e madhe e substancës narkotike të gjetur, e që një sasi është gjetur në veturë e një sasi në lokal.

Konform nenit 71 dhe 72 të KPPRK-së gjykata si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka marrë pranimitin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që ka përcaktuar dënim me burgim nën minimumin e paraparë ligjorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 76 të KPPRK-së të akuzuarit së pari i është përcaktuar dënimi për secilën vepër penale më pas i është shqiptuar dënimi unik si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se dënimet kumulative të shqiptuara janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Konform nenit 79 të KPRK-së të akuzuarit i është llogaritur në dënimin e shqiptuar koha e kaluar në paraburgim sipas aktvendimit PKR.nr.194/22 dt.10.09.2022, aktvendimit PKR.nr.06.10.2022 dhe në arrest shtëpiak sipas aktvendimit PKR.nr.194/22 të dt.05.11.2022, e që kjo masë e arrestit shtëpiak është ndërprerë pas ngritjes së aktakuzës me aktvendim PKR.nr. 243/2022 të dt.29.12.2022.

Konform nenit 267 par.5 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 të KPPRK-së gjykata e mori vendimin mbi konfiskimin e substancës narkotike të llojit marihuanë të gjetura dhe sekuestruara tek i akuzuari siç është përshkruar në dispozitiv të cekur më lartë dhe atë në dy qese najloni dhe të matura ashtu siç ishin fillimisht njëra qese peshonte rreth 1kg e 425 gr, ndërsa tjetra me peshë prej 536, por që pas ekzaminimit dhe matjes ka rezultuar të jenë në peshë të përgjithshme prej 1641.36 gr. substancës narkotike e llojit marihuan. Substanca narkotike në fjalë është send i paligjshme dhe objekt veprës penale si në dispozitivin e parë të cekur më lartë.

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 të KPPRK-së gjykata e mori vendimin mbi konfiskimin e armës- pistoletës së markës S.S. P..., me numër serik se bashku me dy karikator dhe 12 fishekë të kalibrit .x.. mm, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të gjetura dhe sekuestruara tek i akuzuari. Meqë është send i paligjshëm dhe objekt i veprës penale si në dispozitivin e dytë të cekur më lartë.

Konform dispozitës së nenit 260,270 dhe 276 të KPPRK-së gjykata konfiskoj Automjetin xhip i markës A. ..., ngjyrë hiri me targa ..-...-.. me numër të shasisë me pronarë i akuzuari N.I., i konfiskuar më parë sipas urdhrorit PKR.PP.nr.194/22 te dt.12.10.2022 meqë i njëjti është send i fituar dhe i përdorur me kryerjen e veprës penale ku substanca narkotike është gjendur e fshehur në veturë.

Konform dispozitës së nenit 269, 271 dhe 276 të KPPRK-së gjykata konfiskoj shumën të hollave prej 14.075€ (katërmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë euro) të konfiskuara më parë sipas urdhrorit PKR.PP.nr.194/22 te dt.12.10.2022 meqë janë të holla të pa ligjshme të fituara nga vepra penale për të cilën i akuzuari u shpall fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin në paguarjen e paushallit gjyqësor dhe shpenzimeve të procedurës penale.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,
2022:185928, 30.06.2023**

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.